



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Mekanizmi për Parandalimin e Torturës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401359/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve në I.E.V.Penale Kukës.*

**Drejtuar:** Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z.Artur Zoto

**TIRANË**

Drejtorit të I.E.V.Penale  
Z. Endrid DIDA

**KUKES**

**Të nderuar Zotërinj,**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Kukës, më dt. 19.06.2014. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Alfred Koçobashi (drejtues i grupit inspektues), Irena Taga, Alma Alibali N/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës së bashku me ekspertët e Shoqatës Përthyerje në zbatim të marrveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar Parandalues në kuadër të *OPCAT-it* me OJF.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

Me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, kategorizohet institucion paraburgimi".

Në përgatitjen e këtij raporti, nga grupi monitorues u përdor informacioni i mbledhur në I.E.V.P. Kukës nga kjo vizite, nga kontakti me drejtuesin e institucionit dhe përfaqësues të tjerë të administratës së këtij institucioni, nga kontakti me vetë të paraburgosurit, vizita në ambiente të brendshme të paraburgimit, nga verifikimi i të dhënave në regjistrat dhe dosjet e I.E.V.P.-së, si dhe nga krahasimi i këtyre të dhënave me kërkesat e aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

### **Shënime paraprake**

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me përfaqësuesit e lartë të institucionit. Nga ana e përfaqësuesve të lartë të institucionit u shpreh gadishmëria dhe disponibiliteti për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues. Në bisedën paraprake me përfaqësuesit e lartë të institucionit, grupi monitorues evidentoi problemet e konstatuara në këtë institucion gjatë vizitës monitoruese të vitit 2013 kryesisht mbi ambientet tejet të amortizuara të këtij institucioni, kushteve të higjenës së përbashkët e asaj personale, mbi mungesën e kushteve për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, etj.

Në takimin me drejtorin e IEVP Kukës, Z. Endrit Dida grupi monitorues u informua për situatën e përgjithshme në institucion dhe mbi gjëndjen aktuale të këtij institucioni duke evidentuar si problematikën më kryesore faktin që I.E.V.P. ndodhet nëntokë. Z. Dida na bëri me dije se aktualisht në institucion gjënden 27 të paraburgosur prej të cilëve një i mitur, një shtetas maqedonas dhe disa shtetas kosovarë. Kapaciteti zyrtar i paraburgimit është 36-44 persona. Gjithsej regjimi ka 17 dhoma dhe të paraburgosurit janë të vendosur në dhoma teke, dyshe dhe treshe. Nuk ka asnjë të paraburgosur me masa disiplinore, nuk ka të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor ose të sëmurë kronik. Organika është e plotësuar.

Institucioni kishte një dhomë observimi dhe një dhomë veçimi, në të cilat në momentin e monitorimit nuk kishte asnjë person të ardhur apo të veçuar me masa disiplinore. Gjithashtu, në institucion kishte edhe një dhomë të posaçme për ushtrimin e besimit fetar. Institucioni, siç u përmend më sipër, ishte ndërtuar në kohën e monizmit dhe megjithë ndryshimet e modifikimet e bëra trashëgon infrastrukturë tejet të amortizuar. Rregjimi i brendshëm ndodhej nëntokë, në një nivel lartësie prej mbi 1 m e 80 cm nga niveli tokë (niveli 0). Kishte mungesë të sistemeve të ventilimit, ajrimit, ngrohjes qendrore, etj.

I.E.V.P.-Kukes ishte i vendosur në hapësirën e Komisarariatit të policisë së qytetit. Në një përshkrim të rregjimit të brendshëm, dhomat e banimit, kryesisht për 4 persona, nuk kishin tualete dhe lavaman brenda, si dhe ajrimi e ndriçimi natyral ishte i pamjaftueshëm. Për shkak të vendndodhjes të regjimit të brendshëm nëntokë, kishte lagështi në këto ambiente. Të paraburgosurit nuk kishin mundësi të kryenin asnjë lloj aktiviteti fizik, përveç ecjes në ambientin e ngushtë të ajrimit. Megjithatë që nga vizita monitoruese e radhës së shkuar,

në I.E.V.P.-në Kukës ishte krijuar një ambient për takimet familjare brenda në regjim.

Dritaret në dhomat e banimit ishin të siguruara me hekura dhe rrjetë të dendur hekuri, gjë që e bënte të vështirë ndriçimin natyral dhe ajrimin. Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga shefi i sigurisë së Institucionit dhe juristja ekspertëve ju mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm në Institucion në përputhje me standardet e përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që ekspertët do të monitoronin. Objektivi kryesor i vizitës monitoruese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i personave të paraburgosur.

## **Trajtimi**

Në kuadër të monitorimit të të drejtave të të paraburgosurve, grupi i monitorimit monitoroi ambientet e brendshme të institucionit, si dhe komunikoi në privatësi me vetë të paraburgosurit. Në vlerësimin e standarteve në lidhje me trajtimin e të paraburgosurve, grupi monitorues u fokusua kryesisht në çështje si: keqtrajtimet, rastet e masave disiplinore me vendim “veçimin nga ambientet e përbashkëta”, përdorimin e panevojshëm të forcës, apo në tejkalim të rrethanave të rastit, përdorimi i metodave të ndaluara ndaj të paraburgosurve, etj. Gjithashtu, në kuadër të respektimit të së drejtës për dinjitet njerëzor dhe të asaj kundër torturës, grupi monitorues zhvilloi takime në privatësi me vetë të paraburgosurit dhe mbajti shënime informacionin e tyre lidhur me ekzistencën e rasteve të ushtrimit të dhunës fizike e psikologjike, apo të shfaqjeve të pahijshme e fyhese ndaj të paraburgosurve, nga ana e punonjësve të institucionit.

Ankesat që ishin në momentin e inspektimit kishin të bënin më shumë me hapsirën e kufizuar të ajrimit dhe mungesa e aktiviteteve sportive si futboll, basketboll etj, mungesa e detergjenteve, shtimi i dusheve, mungesë medikamentesh mjeksore dhe shërbimit dentar.

Përsa i përket trajtimit të shtetasve të huaj nga Maqedonia dhe Kosova nuk kishte diferencim në trajtim kjo u pohua dhe nga vetë të paraburgosurit Kosovar dhe Maqedonas. Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Nga ana e të paraburgosurve ekspertëve ju bë me dije se nuk kishte raste të ushtrimit të dhunës ose keqtrajtimet prej punonjësve të institucionit. Në optikën e monitorimit të grupit të ekspertëve, ishin edhe masat disiplinore, ligjshmëria e marrjes së tyre dhe më pas kushtet dhe korrektësia e ekzekutimit të tyre. Nga ana e administratës së institucionit ekspertëve ju bë me dije sjellja e mirë, harmonike dhe korrekte e të paraburgosurve ndërmjet tyre, por edhe ndaj punonjësve të administratës, gjë që kishte sjellë që për një kohë të gjatë të mos kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të paraburgosurve.

## **Infrastruktura/Dhomat e banimit dhe kushtet materiale**

I.E.V.P. Kukës ndodhet pjesërisht nëntokë duke i privuar të paraburgosurit nga ndriçimi natyror. Institucioni ka 17 dhoma, një dhomë aktiviteteve, një dhomë takimi me familjarët, një dhomë takimi me avokatin, drejtorin, prokurorin etj. dhe ambientin e ajrimit. Të paraburgosurit janë vendosur nga 1-4 persona në qeli.

Inventari nëpër dhoma është i plotësuar (krevate, tavolina, dollape etj.). Mungon ajrosja e mjaftueshme për shkak të pozicionit të ndërtesës, dhomave të cilat janë të vogla dhe korridorëve të ngushta. Në momentin e inspektimit të paraburgosurit ngritën si shqetësim lejimin e hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen, të paraburgosurit kanë bërë kërkesë për hapjen e dyerve të qelive gjatë ditës por kërkesa nuk u është miratuar nga institucioni.

Në dhoma ka ndricim natyror dhe artificial. Dritaret janë të vogla dhe problem ngelet lagështira për vetë faktin se godina e paraburgimit ndodhet në katin përdhes në bodrum dhe kjo gjë pengon futjen e diellit nëpër dhoma. Dhomat të pajisura me orendit e nevojshme si tavolin, karrige dhe dollap. Carcraftë, jastekët dhe batanijet në shumicën e rasteve ishin sjellë nga familjarët. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte të mira.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të kryer normalisht nevojat e tyre. Megjithëse, në disa raste, pati ankesa, për mungesën e ujit të ngrohtë.

Gjatë dimrit ngrohja realizohet me sobë me dru ndërsa në verë nuk ka një mjet ftohje që të plotësojë kërkesat e të gjithë institucionit.

Për sa i përket pajisjeve elektroshtëpiake kishte dhoma që nuk mungonin si TV dhe frigorifer por dhe të tjera ku mungonin por këtu nuk pati ankesa për vetë faktin se të paraburgosurit pohuan se ishin aty për një kohë të shkurtër. Mungonin mjediset e jashtme të cilat mund të përdreshin për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. I vetmi ambjent ishte ambjenti i ajrimit i cili ishte i kufizuar në hapsirë dhe nuk ofronte asnjë mundësi argëtimi për aktivitetet sportive. Vetë institucioni organizonte spartakiada të ndryshme mes ekipeve në shah dhe domino.

## Higjena

Dhoma dhe korridoret ishin të pastra. Tualeti është i përbashkët ku në të ndodhen 2 ëc të cilave u mungonin kasetat shkarkuese të ujit, 2 lavamane prej të cilëve njëri është në gjëndje të keqe. Në tualete nuk kishte kosha dhe në momentin e inspektimit u vunë re mbeturina në tokë. Dushet janë të përbashkëta, ka vetëm dy dushe të cilat kanë ujë të bollshëm dhe të ngrohtë 24 orë në ditë. Të paraburgosurit kanë bërë kërkesë që të bëjnë dush njëherë në tre ditë por nuk u është miratuar. Aktualisht dushi bëhet njëherë në 5 ditë. Edhe në dushe kemi mungesë koshash. Institucioni për shkak të mungesës së fondeve nuk u jep detergjentë për higjenën personale. Kalendari I dusheve ndodhej I afishuar në dhomën e aktiviteteve. Çerçafët ndërrohen njëherë në 15 ditë, ndërsa problem ngelet lantaria për larjen e rrobaave personale të të paraburgosurve të cilat dërgohen në shtëpitë e tyre dhe lahen nga familjarët.

## Kuzhina

Nga vizita në **kuzhinën** e IEVP-së u vu re që është e vogël por me kushte shumë të mira. Kuzhina ishte e pastër dhe nuk mungonin pajisjet e domosdoshme për gatim dhe mirëmbajtjen e ushqimeve në kushte shumë të mira. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme dhe pastër. Në të punon një kuzhinier dhe një ndihmës kuzhinier. Ambjentet e saj janë të pastra. Në kuzhinë është afishuar menuja ditore. Gramaturat dhe kaloritet janë brenda standarteve. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruhen në

kushte frigoriferike. Pothuajse të gjithë të dënuarit e konsumojnë ushqimin në institucion. Nuk ka raste të refuzimit të ushqimit.

### **Orari veprimeve dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj, ishte i afishuar. Në lidhje me ajrimin, përvec bisedës me të paraburgosurit, u kërkua informacion nga stafi dhe rezultoi se të paraburgosurit qëndrojnë 3 orë në ajrim, 2 orë paradite dhe 1 orë pasdite. Në sallën e aktiviteteve zhvillohej shah dhe domino madje institucioni zhvillonte dhe spartakiada ku për fituesit ofronte cmime me shpërblime si 4 takime dhe 4 telefonata plus.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim shumë i mirë. Ata na informuam për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe pamë me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve. Punonjësit e sektorit të kujdesit social ishin brenda në regjim gjatë vizitës sonë dhe na shoqëruan përgjatë vizitës. Ata kishin programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizonin aktivitete të përbashkëta me të dënuarit, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive si shah dhe domino. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuar shumë mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlersimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentat e tjera mbështetëse.

### **Shërbimi Shëndetësor**

Organika e sektorit të shëndetësisë përbehej nga 3 ndihmësmjekë dhe një mjek i komanduar, i cili punonte me kohë të pjesshme në këtë institucion dhe kishte vetëm një javë që kishte filluar punë. Mungonte stomatologu, por ky shërbim ofrohej nga një subjekt privat, jashtë institucionit.

Gjatë inspektimit tonë në këtë institucion si dhe në bazë të intervistave me të dënuarit, u konstatua se shërbimi shëndetësor në këtë institucion ishte i mirë. Të gjithë të dënuarit shpreheshin të kënaqur nga ky shërbim, si për sa i përket gatishmërisë së stafit mjekësor ashtu edhe kërkesave për konsulta nga specialistë të spitalit rajonal, por kishte ankesa për sa i përket furnizimit me medikamenteve nga ana e institucionit.

Në momentin e inspektimit, nga ky staf u informuam se në këtë institucion ndodheshin tre të sëmurë kronik, të cilët ishin diagnostikuar një me Diabet Mellitus, një me Çrregullime të Sjelljes dhe një me Çrregullime të Ankthit.

Ambulanca mungonte prej kohësh në këtë institucion.

Dhoma e mjekut, infermierisë dhe e farmacisë ishin të rregullta dhe të mirëmbajtur, megjithëse me infrastrukturë të vjetër e të varfra me orendi.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar, regjistri për konsultat jashtë institucionit, si dhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore, megjithëse mbaheshin të mbyllura me çelës, ato nuk plotësoheshin me rregull dhe në disa raste mungonte anamneza. Asnjë nga të gjithë të paraburgosurit nuk ishte i pajisur me librezë shëndetësore, për rrjedhojë mungonte shërbimi

me medikamente sipas skemës së rimbursimit të ilaçeve. Të paraburgosurit i siguronin ato privatisht.

Problemi më madhor i cili u pohua nga vetë të paraburgosurit dhe stafi mjekësor është furnizimi me ilaçe për shkak të mungesës së depos farmaceutike. Dhoma e infermieries ishte në kushte të mira dhe e pastër. Aty nuk mungonin pajisjet e nevojshme. Aktualisht në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë të sëmurë. Stafi i shëndetësis është i përbërë nga një mjek i komanduar i cili nuk vjen çdo ditë dhe në herët kur ai vjen nuk qëndron më tepër se 4 orë. Gjithashtu në paraburgim ka dhe 3 Nd/Mjek. Ka të paraburgosur të cilët ngrejnë pretendimin se kur kanë kërkesa për kontroll apo ekzaminime mjekësore këto kontrole mund të bëhen 4-5 ditë pas kërkesës së tyre. Madje ka nga ata të cilët deklarojnë se shërbimi dentar u është ofruar një muaj pasi i paraburgosuri kishte bërë kërkesën.

## **7. Masat mbrojtëse**

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve cdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të veçantë.

Dhoma e vecimit kishte të njëjtat kushte me dhomat e tjera dhe në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person në vecim apo me masë disiplinore e cila u konfirmua dhe nga bisedat konfidenciale me vetë të paraburgosurit por dhe nga verifikimi i rrejstrave të masave disiplinore.

Për hartimin e ankesë/kërkesave ka një format të veçantë por në I.E.V.P. nuk ka kuti ku ankesë/kërkesat të vendosen në mënyrë anonime. Ato i dorëzohen punonjësës sociale të hapura dhe pasi tërhiqen prej saj, seleksionohen në drejtori për të përcaktuar destinacionin e tyre.

Telefonat punonin në cdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Për sa i përket takimeve ka një ambjente në të cilin të paraburgosurit mund të takohen me familjarët e tyre. Keto ambjente janë të hapura të pajisur me një tavolinë dhe disa stola në kushte jo shumë të mira. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve, ato zhvillohen në rregull sipas planifikimeve dhe survejoheshin në distancë nga punonjës të sigurimit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme që survejonin institucionin për 24 orë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe*

*trajtimin e të dënurave me burgim” ku parashikohet midis të tjerash se: “Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Rregullimin e menjëhershëm të dusheve dhe tualeteve me qëllim ofrimin e larjeve të të dënuarve më shpesh, sidomos në këtë periudhë vere.
2. Pajisjen e dhomës së takimeve me sende të domosdoshme që krijojnë klimën e një takimi familjar në respekt të dinjitetit të të dënuarve dhe familjarëve vizitorë në institucion.
3. Gjetjen e zgjidhjes për vendosjen e kutisë së kërkesë/ankesave që duhet te ekzistojë në seksione, mundësisht afër me telefonin, që të dënuarit ta shfytëzojnë të drejtën e ankimit. Përcaktimin e një procedure për nxjerrjen e kërkesë/ankesave nga seksionet, rregjistrimin e tyre ne rregjistër dhe manaxhimin e kthimit të përgjigjeve apo zgjidhjes së tyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.
4. Afishimin e menusë javore të miratuar në kuzhinën e institucionit, si dhe mundësisht të afishuar brenda në seksione në fillim të cdo jave.
5. Higjienizimin dhe dizinfektimin e kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike.
6. Lejimin e hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen për arsye se koridori është shumë i ngushtë dhe dhomat ndodhen në katin përdhes të godinës gjë e cila pengon dhe nuk lejon ajrosjen e mirë të dhomave.
7. Marrjen e masave urgjente për të rregulluar ambientet e dhomat ku gjithë sektori shëndetësor kryen shërbimet; dhoma ku mjeku bën vizitat, dhoma e infermierisë dhe farmacisë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë.
9. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organikë e mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.
10. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me libreza shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një I EVP në tjetrën.

Në përfundim, bazuar në kushtet e konstatuara ne monitorimin e kryerjes së vizitës, ne viziten pararendese, në analizimin e progresit apo mundësinë për progres ne arritjen e standarteve, grupi i monitorimit arrin ne konkluzionin se kjo I EVP është tejet e amortizuar dhe kushtet e saj demtojnë shëndetin fizik dhe mendor të të paraburgosurve, çënojnë dinjitetin njerëzor të tyre, dhe ne kushtet kur nuk ka asnje mundësi qe keto te korrigojen, **rekomandohet mbyllja e kesaj I EVP-je dhe shperndarjen e të paraburgosurve në paragujimet e tjera.**

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në mungesë dhe me Porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**